

KONTRATE SHIT – BLERJE TE

KUOTES SE KAPITALIT

Sot me date 30 Prill 2023 (dymije e njezet e tre), palet kontraktuese si me poshte:

SHITES:

Shoqeria “Clinical Development Company” shpk, shoqeri e se drejtes shqiptare, e regjistruar prane QKB me NIPT M21401044B, me seli te regjistruar ne Rr.Emin Duraku, Njesia Bashkiake Nr.5, Pallati Binjaket Nr.5, Tirane, e perfaqsuar nga Administratori **Elvin KEDHI**, atesia Vasillaq, shtetas shqiptar, datelindje 23.12.1971, lindur ne Tirane, mbajtes i pasaportes me Nr.personal H11223024Q, madhor dhe i afte te kryeje veprime juridike (ketu e me poshte referuar si “**Shites**”); dhe

BLERES:

Shoqeria “ATG Invest” shpk, shoqeri e se drejtes shqiptare, e regjistruar prane QKB me NIPT M22210005A, me seli te regjistruar ne Rr.Emin Duraku, Njesia Bashkiake Nr.5, Pallati Binjaket Nr.5, Tirane, e perfaqsuar nga Administratori **Luada TOSKA**, atesia Ndririm, shtetase shqiptare, datelindje 24.09.1995, lindur ne Gramsh, mbajtese e leternjoftimit me Nr.personal J55924017E (ketu e me poshte referuar si “**Bleres**”).

(Shitesi dhe Bleresi ne vijim referuar, bashkarisht dhe vecmas, si “Palet”/ “Pale”).

Baza ligjore: Kodit Civil I Republikes se Shqiperise, Ligji nr 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqrite Tregetare” dhe Legjislacioni i fushes ne fuqi.

MEQENESE:

- A. Shitesi eshte njeri prej ortakeve te Shoqerise “Monitorin Clinical Trials” shpk, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me NUIS M223300300, me seli te regjistruar ne adresen: Rr.Emin Duraku, Njesia Bashkiake Nr.5, Pallati Binjaket Nr.5, Tirane, Shqiperi (“Shoqeria”);
- B. Kapitali i Shoqerise eshte 1,000 Leke, i ndare ne 3(tre) kuota me perqindje pjesemarrjeje:
 - Brendi Hoti zoterues i 1(nje) kuote qe perben 20% te kapitalit te Shoqerise;
 - Shoqeria ATG Invest shpk zoteruese e 1(nje) kuote qe perben 5% te kapitalit te Shoqerise; dhe
 - Shoqeria Clinical Development Company shpk zoteruese e 1(nje) kuote qe perben 75% te kapitalit te Shoqerise.
- C. Me Vendimin e Ortakeve bashkangjitur ortaket kane mirtuar shitjen e kuotes se zoteruar nga Shitesi Clinical Development Company shpk tek ortaku tjeter ATG Invest shpk;
- D. Organet kompetente te Shoqerise, te Shitesit dhe te Bleresit kane miratuar te gjitha vendimet e nevojshme per miratimin e ketij transaksioni per kuotat.

BAZUAR SA ME SIPER, Palet pranojne te lidhin kete kontrate qe ekzekuton shitjen e kuotes si vijon:

Neni 1

Kushtet paraprake

1.1 Kushtet paraprake te mesiperme jane pjese thelbesore dhe integrale e kesaj Kontrate.

Neni 2

Ek



Shitja e Kuotes

- 2.1 Nepermjet kesaj Kontrate, Shitesi i shet dhe i transferon Bleresit, e cila pranon dhe blen Kuoten, qe perben 75% te kapitalit te Shoqerise tek Bleresi per cmimin e shitjes prej 750 Leke;
- 2.2 Palet deklarojne qe cmimi i mesiperm eshte shlyer plotesisht.

Neni 3

Deklarime dhe Garanci

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton se eshte i vetmi pronar dhe titullar i Kuotes dhe te drejtave qe rrjedhin prej saj.
- 3.2 Shitesi deklaron dhe garanton se Kuota eshte e lire nga cdo peng, privilegj, barre, apo cdo e drejte tjeter ne favor te te treteve.
- 3.3 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe ne cfaredo momenti tjeter te metejshem pas lidhjes se saj, Shitesi i garanton Bleresit akses – prane selise se Shoqerise – ne origjinalet e librave kontabel te Shoqerise dhe cdo dokumenti tjeter qe aktualisht eshte ne dispozicion/pronesi te Shoqerise, ose qe duhet apo do te jete me pas ne dispozicion/pronesi te saj.
- 3.4 Shitesi deklaron dhe garanton se Shoqeria eshte themeluar dhe operon rregullisht ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne baze te ligjit dhe te akteve te Shoqerise dhe ka te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutit qe rregullon funksionimin e saj.
- 3.5 Shitesi deklaron dhe garanton se Shoqeria nuk ka detyrime ndaj paleve te treta (pervec atyre te bera me dije bleresit) deri ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate. Nese do te rezultojne detyrime te tilla te tjera, Shitesit deklarojne dhe garantojne qe do te jene ne ngarkim te tyre dhe do te shlyeje apo rimbursoje Shoqerine per cdo detyrim.
- 3.6 Shitesi deklaron dhe garanton se Shoqeria nuk eshte ne proces falimentimi dhe likuidimi te vullnetshem ose jo, apo ne ndonje proces te ngjashem.

Neni 4

Korrespondenca

- 4.1 Te gjitha njoftimet, kerkesat apo komunikimet e tjera ndermjet Paleve duhet te behen vetem me shkrim dhe te dergohen prane adresave te seciles Pale, si me siper percaktuar.
- 4.2 Te gjitha njoftimet, kerkesat apo komunikimet e tjera do te dergohen me ane te letres rekomande me kthim pergjigje ose me faks.
- 4.3 Cdo njoftim, kerkese apo komunikim tjeter do te konsiderohet i marre efektivisht nese ekzistojne kushtet e meposhtme: a) eshte derguar me faks, ne momentin ne te cilin eshte marre faksi; b) nese eshte derguar me leter rekomande, ne daten e dorezimit tek marresi qe do te vertetohet me fleten e kthimit.

Neni 5

Shpenzime dhe taksa

EK



5.1 Shpenzimet ligjore si dhe cdo shpenzim tjetër që lidhet me Kontraten apo shpenzimet për veprime të tjera të përfshira në të, do të jenë në ngarkim të Bleresit.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

6.1 Palet angazhohen të zgjidhin me mirekuptim cdo mosmarreveshje që lidhet me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një gjë e tillë nuk është me e mundur, mosmarreveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7

E drejta e zbatueshme

7.1 Kjo Kontrate dhe të drejtat e detyrimit e Paleve do të disiplinohen, interpretohen dhe ekzekutohen në bazë të së drejtës shqiptare.

Neni 8


Vlefshmeria – Origjinalet

8.1 Kjo Kontrate bëhet e vlefshme me nënshkrimet e saj nga Palet. Kjo Kontrate hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe të gjitha të nënshkruara nga Palet.

SHITES

Shoqëria “Clinical Development Company” shpk

Elvin KEDHI



BLERES

Shoqëria “ATG Invest” shpk

Luada TOSKA

Luada Toska

